



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501400/76

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për propozimin e ndryshimit/përmirësimit të VKM Nr. 920, datë datë 23.11.2020 "Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve"*

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Të nderuar,

Gjatë hetimit administrativ që kemi nisur në vitin 2019¹ lidhur me kompensimin e shpenzimeve të transportit për disa punonjës të IEVP Lezhë, të komanduar me detyrë në IEVP "Jordan Misja", kemi marrë në shqyrtim legjislacionin ku parashikohet trajtimi financiar i punonjësve të Policisë së Burgjeve në këto raste.

Në pikën II/1, 2 të VKM Nr. 920, datë 23.11.2020 "Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve", përcaktohet se, punonjësi i Policisë së Burgjeve, kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij, në rast pamundësie të

¹ Disa punonjës të policisë së IEVP Lezhë, gjatë kohës që ishin të komanduar me detyrë në IEVP "Jordan Misja", Tiranë janë ankuar para ndihmëskomisionerit të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ndodhej në këtë IEVP për të verifikuar ankesën e një të paraburgosuri. Hetimi i ankesës së paraqitur nga punonjësit e policisë së IEVP Lezhë ka zgjatur në kohë për shkak të përgjigjeve jo shteruese që kemi marrë, kërkesave tona të përsëritura për informacion dhe domosdoshmërisë për të marrë sqarime në IEVP Lezhë, nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Këta punonjës të policisë së IEVP Lezhë kanë qenë të interesuar në vijimësi për zgjidhjen e kësaj situate e duke mos u adresuar shqetësimet e tyre, kanë paraqitur ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

garantimit nga institucioni të transportit nga vendbanimi deri në vendin e punës, përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit dhe ky kompensim është në masë në lekë për muaj, **në varësi të distancës në km, të vendit të punës me vendbanimin e punonjësit.** Kjo masë kompensimi është parashikuar sipas tabelës si më poshtë vijon:

Distanca në kilometra	Masa e kompensimit në lekë për muaj
Nga 36 km deri 60 km	3000 lekë/muaj
Nga 61 km deri 100 km	5000 lekë/muaj
Nga 101 km deri 150 km	8000 lekë/muaj
Nga 151 km deri 200 km	10 000 lekë/muaj
Mbi 200 km	15 000 lekë/muaj

1. Avokati i Popullit vlerëson se parësore është që lëvizja të organizohet e kryhet nga vetë institucioni. Por, vërejmë se masa e shpërblimit është zgjidhje parësore e përdorur në këtë rast. Pavarësisht masave të marra dhe punës për realizimin e transportit me mjetet e institucionit, vlerësojmë se ka vend për ndryshim edhe në masën e kompensimit të parashikuar në këtë rast, pasi ai nuk konsiderohet i mjaftueshëm për qëllimin, për të cilin jepet.

Ndryshimet që kanë ndodhur në kostot e transportit nuk janë reflektuar, ndërsa çmimet sipas INSTAT-it, kanë ndryshuar. Kështu, për sa i përket të dhënave për muajin Nëntor 2023, indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Nëntor 2023, arriti 115,3 kundrejt muajit Dhjetor 2020². Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2023 është 3,9 %, kurse një vit më parë ky ndryshim ishte 7,9 %³.

² Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet duke iu referuar muajit Dhjetor 2020 që shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

³ https://www.instat.gov.al/media/12826/ick_n%C3%ABntor_2023.pdf

2. Nga ana tjetër, së fundmi jemi njohur me VKM Nr. 722, datë 13.12.2023 “Për disa të drejta të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”⁴. Në pikën 1 të saj, është vendosur si më poshtë vijon:

“1. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (në vijim “punonjësi i Agjencisë”), i emëruar në detyrë, i cili me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë transferohet ose emërohet, në përputhje me funksionin që mban, brenda strukturave qendrore dhe vendore të Agjencisë, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, si më poshtë vijon:

a) nga 36 km deri 60 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/muaj;

b) nga 61 km deri 100 km, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj;

c) nga 101 km deri 150 km, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë/muaj;

ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë/muaj;

d) mbi 200 km, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/muaj”.

Dy VKM-të e lartpërmendura, parashikojnë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe atyre të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, kur ato transferohen ose komandohen me detyrë jashtë vendbanimit. Kompensimi është caktuar në masë fikse në varësi të distancës së vendbanimit të punonjësit me vendin e punës. Por, ndërsa distanca e përcaktuar për t’u kompensuar është e njëjtë për dy kategoritë e punonjësve, shumta e kompensimit është më e madhe për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Çmujmë se ky trajtim ndryshe ndërmjet punonjësve të administratës shtetërore përbën trajtim të pabarabartë përpara ligjit.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18⁵, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë

⁴ Fletore Zyrtare Nr. 181, datë 15.12.2023.

⁵ Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”*. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim se *“Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin konkret kemi të bëjmë me individë në kushte të njëjta dhe trajtim ndryshe, dallim ky i papërligjur dhe pa shkaqe të arsyeshme. Për më tepër, VKM Nr. 722, datë 13.12.2023 *“Për disa të drejta të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”*, ka marrë parasysh rritjen e çmimit të karburantit, gjë që nuk është pasqyruar në VKM Nr. 920, datë 23.11.2020 *“Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”*.

Shqetësim i vazhdueshëm i ngritur nga ana jonë është, organika e paplotësuar e stafit policor në IEVP, për shkak të largimeve të tyre dhe vështirësisë për të gjetur zëvendësues. Trajtimi jo i duhur financiar i tyre nuk e përmirëson situatën. Kontributi i punonjësve të Policisë së Burgjeve është i domosdoshëm për të garantuar sigurinë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të vendit tonë. Pavarësisht rritjes së pagave sipas gradave për punonjësit e Policisë së Burgjeve, nuk duhet të kemi hapa pas, pasi është evidentuar që sistemi i burgjeve po përballet me vështirësi në ruajtjen e stafit në mënyrë të qëndrueshme dhe profesionale. Goditja e krimit shkon në të njëjtin hap me përmirësimin e sistemit penitenciar për të përballuar reagimin e këtyre të fundit.

Për sa më lart, plotësohen kushtet e nenit 24, paragrafi i parë, shkronja (a) të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se:

“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkakun që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve”.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e nismës për propozimin e ndryshimit/përmirësimit të VKM Nr. 920, datë 23.11.2020 “Për trajtimin me pagë e shtesë mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, ku masa e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, të jetë e barabartë me atë të përcaktuar për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi